



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.342/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidates për kuvend komunal në Pejë Shemsije Seferia ngasubjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Pejë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Pejë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të dt. 22.10.2017.

#### A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë me të cilën pretendon se kandidatja për kuvend komunal në Pejë Shemsije Seferi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Pejë, ka bërë fushatë politike duke shpërndarë foto me thirrje për ta votuar PDK-në dhe atë si kandidate për kuvend komunal.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e kandidates nga subjekti politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë e refuzoj ankesën, për arsye se nga fotografitë e ofruara si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore sepse nga përmbajtja e sms-së del se kandidatja në fjalë nuk ka bërë thirrje për ta votuar subjektin e caktuar politik, mirpo

përmbajtja është e përgjithshme dhe në mungesë dëshmive të qarta dhe bindëse siç kërkohen me nenin 117 të LZP-së, paneli vendosi që ankesa e ankuesit të refuzohet.

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.342/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

Rafet Haxhaj



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.